

Violeta Shkurta




PROKURORE NË PROKURORINË  
E FIERIT

Deklaratat e analizuara:

16 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri  
Periodik/Vjetor 2018)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklaramit deri në vitin 2018




Pasuria bruto është rritur 2 herë.

+ 535,652 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë



## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2018	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga nga funksioni	15,709,431	60.7%
Të ardhura nga paga e familjarëve	7,386,261	28.5%
Të ardhura nga biznesi	1,380,000	5.3%
Të ardhura nga Qira	857,500	3.3%
Të ardhura të tjera	538,560	2.1%
<b>Total</b>	<b>25,871,752</b>	<b>100%</b>



## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 15 vite rezultoi:

**1 deklaratë Me probleme**  
**14 deklarata Pa Probleme**



Në vitin 2005, subjekti rezultoi me burime financiare të pamjaftueshme në vlerë 1,010,605 lekë për të mbuluar blerjen e një apartamenti banimi me vlerë totale 8,460,000 lekë (sipërfaqe 180m<sup>2</sup> në Fier) për të cilin paguan vetëm këstin e parë, duke i mbetur detyrim firmës vlerën 5,560,000 lekë. Ky detyrim do shlyhet në vitin 2006 falë kredisë bankare të marrë këtë vit në vlerën 4,500,000 lekë.

Në vitin 2011, subjekti deklaroi të ketë përfituar nga privatizimi apartament banimi sipërfaqe 36.3m<sup>2</sup> (për të cilin nuk jep vlerë aset) dhe truall me vlerë 174,802 lekë në Fier. Gjithashtu në prill 2011 deklarohet të ketë përfituar nga Bashkia Fier një kredi me kushte lehtësuese për blerje apartamenti në shumën 4,404,960 lekë, e cila në fakt është përdorur për shlyerjen totale të kredisë ekzistuese.

Në vitin 2018, bashkëshorti i subjektit deklaroi marrje me huapërdorje pa kundërshtim tokë are në Fier për ekonomi bujqësore familjare.